



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 363/1 Prot.

Tiranë, më 03 . 03 . 2025

V E N D I M

Nr. 43 , Datë 03 . 03 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është regjistruar ankesa me nr. 47 Regj, datë 25.02.2025, paraqitur nga znj. D. P, kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të vajzës të saj të mitur D. P, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të motrës së saj.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, znj. D. P, në mes të tjerash, parashtron si më poshtë vijon:

“Jam nëna e dy vajzave binjake. Njëra prej binjakeve vuan me çrregullim të spektrit autik, kurse tjetra është nxënëse në klasën e gjashtë pranë shkollës 9-vjeçare “Sotir Gura”, Korçë. Po ju drejtohem ju si Institucion, pasi pretendoj se Drejtoria Mbështetëse e Kopshteve e Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë, nuk e ka trajtuar fëmijën tim me bursë na bazë të VKM nr. 666/2019.

Në muajin tetor 2024, kam dorëzuar pranë Shkollës së vajzës time, D. P, dokumentacionin për përfitimin e bursës në bazë të VKM nr. 666/2019, pasi vajza tjetër imja K. P, është më aftësi të kufizuar (AK).

Në muajin janar 2025, jam lajmëruar se vajza ime D nuk është përfituese e bursës. Kërkoj shpjegime, pasi për përfitimin e bursës thuhet që duhet të jetë një anëtar i familjes që të gëzojë

statusin e personit me AK, ndërkohë që unë kam vajzën binjake që është e sëmure me çrregullim të spektrit autik. Nuk e kam të qartë se përse nuk merret parasysh dokumentacioni që kam dorëzuar që provon që vajzat janë binjake.”

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri: *“Hetimin e rastit për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të vajzës K. P, si dhe përfitimin e bursës për vajzën D. P, bazuar në VKM nr. 666/2019”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, si dhe rrethanave të shpjeguara, lidhur me mospërfitimin e bursës nga vajza e saj, D. P, Komisioneri, konstaton se:

- Referuar Certifikatës Familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile nr. 245, Njësia Administrative Mollaj, Korçë, dëshmohet se D dhe K. P janë vajzat binjake të znj. D. P.
- Referuar Vërtetimit me nr. 130 prot., datë 14.01.2015, të shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë, vërtetohet se D. P është nxënëse e klasës së gjashtë, në vitin shkollor 2024-2025.
- Referuar Vërtetimit për Aftësinë e Kufizuar, datë 26.02.2024, lëshuar nga Zyra Rajonale e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Korçë/Shërbimi Social Shtetëror me afat vlefshmërie deri me datë 01.03.2027, konstatohet se, fëmija K. P, është diagnostikuar me: xxxxxxxx dhe yyyyyy.
- Bazuar në deklaratimet e ankueses, në muajin tetor 2024, ajo ka depozituar pranë Shkollës, dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e bursës për vajzën D. P, bazuar në kriterin joekonomik (duke depozituar dokumentacionin mjekësor për vërtetimin e AK-së së vajzës binjake, K. P).
- Ankuesja nuk ka parashtruar, pretenduar apo depozituar dokumentacion provues, që të kishte aplikuar për përfitimin e bursës bazuar në ndonjë kriter tjetër, përveç kriterit joekonomik.
- Në muajin janar 2025, ankuesja ka marrë përgjigje refuzuese lidhur me miratimin e bursës.
- Subjekti ankues pretendon para Komisionerit se, vajza e saj, D. P, nxënëse e klasës së gjashtë në shkollën 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë, duhet të jetë përfituese e bursës, bazuar në AK që posedon njëri nga anëtarët e familjes.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së znj. D. P, Komisioneri ka analizuar VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, qëllimi i së cilës është garantimi i së drejtës së fëmijës për arsim.

Në pikën 1, të VKM-së sipërcituar, përcaktohet se:

“Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional”.

Në pikën 2, të këtij vendimi përcaktohet se:

“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:

2.3 Kriteri joekonomik:

.....

d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit:

.....

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe kritereve të përcaktuara në VKM-në sipërcituar, për përfitimin e bursës së fëmijës D. P, bazuar në kriterin joekonomik, do të duhej që statusin e invalidit, (AK) ta gëzonte njëri nga prindërit e saj, dhe jo një familjar tjetër (përveç prindit), siç është në rastin konkret motra e saj binjake.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, bazuar në përcaktimet e VKM-së respektive, rrethanat e shpjeguara, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, nxënësja D. P, nuk plotëson kriteret përkatëse për përfitimin e bursës, bazuar në kriterin joekonomik (referuar AK-së që gëzon motra e saj).

Në këto kushte, KMD, gjykon se pretendimi i subjektit ankues është haptazi i pabazuar dhe se, për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ.

Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për trajtim të padrejtë apo të pabarabartë, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 47 Regj., datë 25.02.2025, të paraqitur nga znj. D. P, pasi është e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA